

Z. Arsim Janova  
Udhëheqësi i Bordit të ZRRE-së  
Zyra e Rregullatorit për Energji  
Kosova \*

Me email: info@ero-ks.org

Vjenë, 15 maj 2019

REG-KS / O / 03 / 15-05-2019

**Re: Konsultimi publik në lidhje me mbështetjen për objektivat shtesë të BRE-ve**

Që nga aderimi i Kosovës\* në Komunitetin e Energjisë, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë është duke ndjekur nga afër zhvillimin e tregjeve të energjisë në Kosovë \* dhe ka qenë dhe është i etur që të ndihmojë dhe mbështes Kosovën \* në zhvillimin e tregjeve të energjisë, në përputhje me acquis Komunitetin e Energjisë.

Në përputhje me synimet e Komunitetit të Energjisë, një fokus i veçantë mbetet në zhvillim dhe integrimin e tregut të energjisë nga burimet e rinovueshme (BRE).

Në këtë drejtim, vëmendja jonë u nxitë kohëve të fundit në konsultimin publik në lidhje me mbështetjen për një energji shtesë diellore prej 20 MW. Prandaj, me dashamirësi do të donim të parashtrojmë komentet vijuese.

Sekretariati përshëndet ambicjen e Kosovës për të arritur një objektiv të vullnetshëm të BRE-së prej 29% dhe një objektiv shtesë për energjinë diellore prej 20 MW. Megjithëse Sekretariati dëshiron të tërheqë vëmendjen tuaj në shembullin e Malit të Zi, ku projektet e BRE tashmë janë duke u zhvilluar pa asnjë mbështetje shtesë nga shteti, ne e pranojmë që në dritën e zhvillimit aktual të tregut të teknologjisë dhe tregut, energjia elektrike nga BRE-të në përgjithësi mund të mbështetet nga shteti në mënyrë që të promovojë përdorimin e saj. Megjithatë, çdo mbështetje e tillë duhet të jetë në përputhje me ndihmën shtetërore të acquis të Komunitetit të Energjisë.

Përderisa palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë janë nën detyrimin për të përmbushur objektivat për energjinë e rinovueshme, është në interesin e tyre dhe në interesin e konsumatorëve, veçanërisht të qytetarëve, ta bëjnë këtë me kosto më efektive. Mbështetja e BRE-ve nga shteti duhet të synojë të promovojë përdorimin e energjisë elektrike nga BRE, por jo duke mbështetur padrejtësisht prodhuesit e BRE-ve në dëm të konsumatorëve.

Kjo arrihet më së miri duke lehtësuar konkurrencën midis zhvilluesve të besueshëm të BRE-ve gjatë aplikimit të Ndihmës shtetërore. Konkurrenca është një mjet transparent për të identifikuar nivelin e mbështetjes që duhet të ofrohet për BRE-të dhe për të zgjedhur projektet për të cilat ofrohet mbështetje.

Përkundër mbështetjes së dhënë në nivelin e përcaktuar nga administrata, procedurat konkurruese të ofertave inkurajojnë prodhuesit e BRE-ve jo vetëm të zhvillojnë projekte me kosto efektive, por përmes mjeteve të procesit të tenderimit konkurrues, të zbulojnë kostot e projektit dhe ndihmohet në përcaktimin e duhur të nivelit të mbështetjes shtetërore. Ndërkohë që mbështetja administrative e vendosur mund të shkëputet nga realiteti i tregut, oferta konkurruese mund të ulë shpenzimet në mënyrë efektive. Kjo ka qenë dëshmi në procedurat e ofertave konkurruese të zbatuara në një numër vendesh në faza të ndryshme të zhvillimit. Si një shembull të kohëve të fundit në rajonin e Komunitetit të Energjisë, po i referohemi ankandëve të mbajtura në Shqipëri në gjysmën e dytë të vitit 2018 ku mbështetja për ndërtimin e një centrali diellor prej 100 MW arriti një nivel prej 59.9 EUR/MW për 50 MW (ndërsa 50 MW e mbetur do të ndërtohen pa mbështetje shtetërore).

Procedurat me oferta konkurruese gjithashtu sigurojnë një mjet transparent dhe objektiv për identifikimin e përfituesit të kësaj mbështetje financiare dhe konsumatorët përfitojnë nga ky ndryshim në mbështetjen e shtetit nëpërmjet kostove më të ulëta.

Prandaj, si një rregull i përgjithshëm, bazuar në Udhëzimet e BE-së mbi Ndihmën Shtetërore në Ndihmën në Mbrojtjen Mjedisore dhe Energjisë 2014-2020, oferta konkurruese është e mandatuar në BE dhe Komunitetin e Energjisë për shumë projekte të BRE-ve.

Meqenëse është detyrë e autoritetit rregullator për të mbrojtur konsumatorët dhe për këtë arsye të shmangët mbikompensimi i investitorëve, Sekretariati ju inkurajon fuqishëm që të mos e vendosni përkrahje për caqet shtesë administrativisht siç theksohet në raport për konsultim publik, por me anë të një procedure të ofertave konkurruese.

Ju lutemi pranoni shprehjen e konsideratave tona më të larta.

Janez Kopac  
Drejtor

Dirk Buchle  
Zëvendës Drejtor/ Këshilltar Ligjor